



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.10176/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Naime Ahmeti e Fatmir Baloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi - Saraçi, në çështjen kontestimore të paditëses K..., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit M. B nga Komuna e Malishevës, për shkak të kompensimit të dëmit material, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë C.nr.487/2021 të datës 03.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.04.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e të paditurit M. B, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, C.nr.487/2021 i datës 03.11.2021, VËRTETOHET.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, miratohet kërkesëpadia e paditësit K... me seli në Prishtinë, në tërësi si e bazuar. Detyrohet i padituri M. B nga Komuna Malishevë, t'ia kompensoj shumën prej 219.02€, për dëmin e shkaktuar material K..., me kamatë prej 8% duke filluar nga nxjerrja e aktgjykimit datë 03.11.2021 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar i padituri, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj apo të njëjtin ta prishë dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja K... ka parashtruar padi ndaj të paditurit M. B, me të cilën ka kërkuar që i padituri t'ia kompensoj shumën prej 219.02€, për dëmin e shkaktuar material K..., me kamatë prej 8% duke filluar nga nxjerrja e aktgjykimit datë 03.11.2021 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se sipas aktgjykimit penal të formës së prerë të Gjykatës Themelore të Gjakovës, dega në Malishevë P.nr.397/18 të datës 23.10.2019 i cili ka marrë formën e prerë me datë 28.06.2020, i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përderisa e dëmtuara tani paditësi për kompensimin e dëmit të shkaktuar në lidhje me veprën e lartpërmendur penale është udhëzuar në kontest civil. Me veprimin e tij i padituri, i ka shkaktuar dëmin material në vlerë prej 219.02€

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: "Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji".

Neni 195.1 i LPK-së: "Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur".

Neni 195.1 i LPK-së: "Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:e) ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë".

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se në rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në nenin 150.1 të LPK-së, është përcaktuar se *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht”*.

Kolegji vlerëson se ankesa e paditësit, e cila ka atakuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë shfaqet e pa bazuar pasi paditësi nuk ka shfaqur pretendime se të njëjtit nuk i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi. Tutje gjykata e shkallës së dytë vlerëson se themelësia e kërkesëpadiës buron nga faktet e treguara në padi që janë, Aktgjykimi penal me nr.P.nr.397/18 i datës 18.10.2019, nga i cili është vërtetuar se nga veprimet e të paditurit, paditëses i është shkaktuar dëmi material, si në dispozitivin e aktgjyimit të atakuar me ankesë.

Përfundimisht, Kolegji i Gjykatës së Apelit, gjen se, nga shkresat e lëndës shihet se paditësi me datë 12.10.2021, personalisht i ka marr aktvendimin për përgjigje në padi të datës 01.10.2021, së bashku me padinë dhe provat materiale, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në padi. Nga të lartcekurat kolegji ka refuzuar pretendimet e të paditurit, duke vërtetuar aktgjykimin e atakuar me ankesë.

Bazuar në nenin 319.1 të LPK-së, secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Kolegji vlerëson se pala e paditur në procedurën e zhvilluar nuk ka arritur të bëjë një gjë të tillë, andaj edhe ankesa e parashtruar për këtë çështje, është vlerësuar si e pa bazuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10176/2021 me datë 08.04.2024

Kryetari i kolegjit- gjykatësi,

Dr.sc. Rafet Haxhaj